



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:091581

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06993732

PKR.nr.145/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari Fatos Sejdiqaj, me zyrtaren ligjore Atdhetare Bashota-Krasniqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.S. nga Mitrovica, për shkak të veprave penale I.-Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), II.-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), dhe III.-Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.121/2018 të datës 13.12.2018, për pikën II rikualifikuar nga Prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar datë 13.02.2025 nga vepra penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 të KPRK-së, në veprën penale – Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe publik datë 13.02.2025, në të cilin në prezentë ishin Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari B.S. dhe Mbrojtësi i tij caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Besim Parduzi, Gjykata me datë 14.02.2025 ka shpallur publikisht, ndërsa më datën 14.03.2025 e përpiloi me shkrim këtë :

NË EMËR TË POPULLIT

A K T G J Y K I M

- Kundër të akuzuarit :

B.S., nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur me datë në Mitrovicë, ku dhe tani jeton me adresë vendbanimi në fshatin, me numër personal:, shqiptar, shtetas

i Republikës së Kosovës i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, me profesion-Mjeshtër ndërtimarie, i gjendjes së mesme ekonomike.

I

- Në mbështetje të nenit 362 par.1, pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës :

REFUZHET AKUZA

- **Sepse** : Me datë 04.09.2018 rreth orës 14:00, në rrugën “.....” në Mitrovicë, i pandehuri B.S. pa autorizim ka posdeuar substanca psikotrope ose analoge të llojit “marihuanë” ashut që nga ana e Njësisë së DHTN Regjioni Veri është ndalur automjeti i markës “.....” ngjyrë hiri, me targa, të cilin e drejtonte vozitësi - dëshmitari B.K., ku si pasagjer ishte i pandehuri B. dhe gjatë kontrollës tek i pandehuri janë gjetë 4 gram substanca narkotike "mariuhanë", ndërsa tek ndërruesi i shpejtësisë janë gjetur edhe 0.4 gram, të cilat i pandehuri i ka blerë nga një person në Mitrovicë, të cilat substanca narkotike janë konfiskuar nga ana e policisë, e që pas ekspertizës së forenzikës ka rezultuar që pesha neto ka qenë 3.77 gram.

- **Me këtë kishte për të kryer veprën penale – Posedimi i paautorizuar i narkoitkëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.**

II

ËSHTË FAJTOR

- **Sepse** : Prej kohës së pacaktuar e deri me datën 04.09.2018, rreth orës 16:00 minuta, në shtëpinë e të pandehurit e cila gjendet në fshatin, komuna e Mitrovicës, i pandehuri pa autorizim ka kultivuar bimën narkotike "fije kanabisi" në pronën e tij, ashtu që gjatë bastisjes nga ana e policisë është gjetur një bimë e llojit "kanabis" e shkukur afër shtëpisë, me gjatësi 110 cm, të cilën i pandehuri e kishte mbjellë në arën e tij, e cila është konfiskuar nga ana e policisë dhe pas e ekspertizës ka rezultuar me peshë neto 52.72 gram.

- **Me këtë ka kryer veprën penale - Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

III

ËSHTË FAJTOR

- **Sepse** : Në të njëjtën ditë, kohë dhe vend si nën pikën II të dispozitivit, në shtëpinë e tij, ka mbajtur në pronësi, në kontrollë ose në posedim armë, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e

tilla, ashtu që gjatë bastisjes së policisë në shtëpinë e të pandehurit B.S. është gjetur një pushkë me numër serik 87875, një pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik 3 - 9X40EG, pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik 3 - 9X40, pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik ZH204 - ZH224, e po ashtu i janë gjetur edhe 5 paketime me mjete eksplozive, ku katër paketime janë dyshe dhe një paketim është treshe, ku gjithsej 11 mjete eksplozive, të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë.

- Me këtë ka kryer veprën penale – Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 42, 45, 73, 74, 75 par.1, pika 1.3 dhe 76 par.1, pika 1.5 dhe nenit 273 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së :

Të akuzuarit :

I C A K T O N

- Për pikën II, për veprën penale : **Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të KPRK-së**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

- Për pikën III, për veprën penale: **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Gjykata në kuptim të nenit 80, par.2, nënpar.2.2 të KPRK-së, të akuzuarin e:

- G J Y K O N -

I.- Dënim me burgim unik në kohëzgjatje prej shtatë (7) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që Aktgjykimi të merr formën e prerë.

II.- Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 278 par.2 të KPRK-së dhe 374 par.3 lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, nga i akuzuari Urdhëron konfiskimin e përhershëm të :

a). Substancës narkotike-të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme : 56.49 ± 0.0001 gram, si dhe

b). Një (1) pushkë me veprim shul “Crvena Zastava”, model M70, me numër serik: 87875, e kalibrit 8x57JS, një pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik 3 - 9X40EG, pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik 3 - 9X40, pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik ZH204 - ZH224 dhe njëmbëdhjetë (11) paketime me eksplozivë.

c). Urdhërohet Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëjë asgjësimin e substancës narkotike si dhe shkatërrimin e armës së zjarrit dhe eksplozivëve, sipas procedurave ligjore në fuqi.

III.- I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të cilat do të paguhen nga mjetet buxhetore të Gjykatës, kurse obligohet i akuzuari që për veprat penale si në pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit, t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50.00) Euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Kërkesë pasurore – juridike sipas aktakuzës nuk kishte.

A r s y e t i m

- Aktakuza -

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, më datën 13.02.2018, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.121/2018, kundër të akuzuarit B.S. nga Mitrovica, për shkak të veprave penale I.-Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, II.-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 të KPRK-së, rikualifikuar nga Prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar të datës 13.02.2025 në veprën penale-Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të KPRK-së dhe III.-Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

- Rrjedha e procedurës penale -

- Më datë 13.02.2025 Gjykata në kuadër të kompetencës lëndore dhe territoriale ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar e cila ka qenë e hapur për publikun, në prezencën e palëve Prokurores së shtetit Fetije Bajrami, të akuzuarit B.S., si dhe mbrojtësit të tij caktuar sipas detyrës zyrtare av.Besim Parduzi.

- Gjykata konform nenit 241 par.1 të KPP-së, të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale, ka deklaruar se nuk ka angazhuar mbrojtës, por që është pajtuar ta mbrojë mbrojtësi sipas detyrës zyrtare Av.Besim Parduzi.

- Duke qenë se në këtë çështje penale i akuzuari akuzohej për veprat penale si dipsoziv të aktakuzës, për të cilat vepra penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, meqenëse mbrojtja është e detyruar, Gjykata duke vepruar në përputhje me nenin 56 par.1, nënpar.1.3 të KPP-së, me aktvendim procedural për mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike të akuzuarit i ka caktuar Av.Besim Parduzi, i cili ka qenë i angazhuar dhe në fazën e procedurës parapenale.

- Refuzimi i akuzës për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit –

- Në shqyrtimin fillestar të datës 13.02.2025 para leximit të aktakuzës Prokurorja e shtetit, deklaroi se tërhiqet nga akuza dhe ndjekja penale për pikën I të dispozitivit të aktakuzës, për veprën penale-Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se prokuroria e shtetit ka të drejtë ligjore në çdo kohë të tërhiqet nga akuza dhe ndjekja penale, nga hapja e deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Mbi këtë bazë dhe rrethanë, Gjykata në mbështetje të nenit 362 par.1, nënpar 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ka konstatuar se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit refuzues, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të saj.

- Gjykata ka gjetur se në bazë të përshkrimit faktik dhe shkresave të lëndës rrjedh se i akuzuari dyshohet se veprën penale-Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, e ka kryer me datë 04.09.2018, është përcaktuar dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

- Sipas nenit 106 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të KPRK-së përcaktohet se, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: *“tre vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se një (1) vjet burgim”*. Ndërsa sipas nenit 107, par.8 të KPRK-së, përcaktohet se : *“ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)”*.

Gjykata rithekson se i akuzuari këtë vepër penale dyshohet ta ketë kryer me datë 04.09.2018, ashtu që nga kjo kohë e deri më tani kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) vjet, që do të thotë se ka kaluar dyfishi i afatit që kërkohet për arritjen e parashkrimit absolut të ndjekjes penale në bazë të nenit 106 par.1, nënpar.1.5 lidhur me nenin 107 par.8 të KPRK-së.

- Neni 362 par.1 pëcakton se : *“Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur”* : nënpar.1.1 *“prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor”*.

- Vlerësimi i pranimit të fajësisë për veprat penale në pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit –

- Para leximit të aktakuzës Prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar të datës 13.02.2025, sa i përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës për veprën penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 të KPRK-së, bëri rikualifikimin ligjor të saj në veprën penale-Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të KPRK-së njëehritë, ka plotësuar përshkrimin faktik të kësaj vepre penale në fillim të saj që duhet të jetë : *“Prej kohës së pacaktuar e deri me datën 04.09.2018”* duke theksuar më tej se pjesa tjetër e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pandryshuar.

- Pas leximit të aktakuzës dhe veprës penale të rikualifikuar nga ana e prokurores së shtetit, Gjykata të akuzuarin e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe beneficionet e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për pikën II të rikualifikuar si dhe për veprën penale si në pikën III për të cilat akuzohet, pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do t'i përsërisë veprimet e tilla dhe se lidhur me sjelljet dhe veprimet e tij është penduar thellësisht për çka sinqerisht kërkojë falje.

- Gjykata, ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe atë, nga Prokurorja e shtetit e cila ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponime, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij si dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me pasojat dhe beneficionet e pranimit të fajësisë, i cili mbështetet edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj të njëjtën.

- Mbrojtësi i të akuzuarit B.S., Av.Besim Parduzi lidhur me pranimin e fajësisë së të mbrojturit të tij ka deklaruar se, pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës dhe pas njoftimit nga Gjykata me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e njëjta bazohet në fakte, ashtu që i ka propozuar Gjykatës që gjatë shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh faktin i akuzuari e ka pranuar fajësinë, më parë nuk

ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, kohën e gjatë të kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet si dhe faktin se që nga kjo kohë nuk ka kryer vepra penale dhe tani është rehabilituar dhe është anëtarë produktiv i shoqërisë.

- Gjendja faktike e vërtetuar –

- Gjykata në mbështetje të nenit 242 par.2, lidhur me par.6 të KPP-së, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i akuzuari për këto dy pika (II dhe III) të aktakuzës, dhe ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë. Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga i akuzuari mbështetet në tërësi në provat që përmbanë kjo akuzë, siç janë : Raporti i oficerit policor nga Drejtoria për Hetim dhe Trafikim me Narkotikë-DHTN në Mitrovicë Nr.2018-DHTN-791 i datës 04.09.2018, Procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave Nr.2018-DHTN-791 datë 04.09.2018 përpiluar nga DHTN në Mitrovicë, Lista e gjërave të sekuestruara Nr.2018-DHTN-791 datë 04.09.2018 përpiluar nga DHTN në Mitrovicë, Lista e dëshmimeve e datës 04.09.2018, Përmbajtja e dosjes së forenzikës së bashku me Raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes prej dy (2) faqe dhe Fotoalbumin e vendit të ngjarjes gjithsej pesëmbëdhjetë (15) faqe Nr.2018-DHTN-791 datë 04.09.2018, Raporti i Ekspertimit lidhur me ekzaminimin e substancës narkotike Nr.AKF/2018—2731/2018-2703 i datës 26.10.2018 dhe raporti i ekspertimit lidhur me ekzaminimin e armëve të zjarrit Nr.AKF/2018—2731/2018-2704 i datës 18.09.2018 të punuara nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, si nga vështrimi në të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Të gjitha provat si më lart janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë tyre dhe pranimit të fajësisë nga i akuzuari, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprat penale-Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

- Gjykata gjen se i akuzuari në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij para dhe gjatë seancës. Gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë nuk mund të paraqesë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humbet mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave tjera, se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që i shkon në favor të akuzuarit me rastin e caktimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata konstaton se aktakuza në këtë rast nuk përmban ndonjë shkelje ligjore apo ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e saj.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –

- Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarin ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës, si rrethana rënduese janë marr parasysh; dashjen direkte, kontributin e tij te veprat penale, sasinë e narkotikëve që ka poseduar, faktin se kjo natyrë e veprave penale paraqet rrezikshmëri të lartë për shoqërinë dhe për shëndetin e qytetarëve, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë më të shpeshtuara në Kosovë të shprehura e në tendencë të rritjes, pastaj shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këto dy vepra penale, dhe faktin se për një kohë të gjatë ka mbajtur armën pa leje.

Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, ka shprehur publikisht keqardhje dhe pendim për rastin. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprat penale që akuzohet që nga momenti i parë, duke bashkëpunuar kështu në mënyrë të plotë me organet e rendit, duke ndihmuar në zbardhjen e plotë dhe të tërësishme të veprës penale.

- Gjykata me rastin e caktimit të dënimit, vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit për veprën penale si në pikën II të aktgjykimit, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 75 par.1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, në të cilën dispozitë ligjore parashihet se : Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rast kur kryesi pranon fajësinë. Në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, në të gjitha fazat e procedurës penale, andaj Gjykata të njëjtit i shqiptojë dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjor për këtë veprë penale, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit e ka bërë në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit të paraparë në dispozitën ligjore nga neni 76 par.1, nënpar.1.5 të KPRK-së, në të cilën parashihet “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”. Në rastin konkret për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij atkgjykimi për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, për shkak të veprës penale-Kultivimi i bimës së hashashit, shkures së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

- Sipas bindjes së Gjykatës, dënimi me burgim unik në kohëzgjatje prej shtatë (7) muaj ndaj të akuzuarit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

- Andaj, Gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për konfiskim –

- Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 278 par.2 dhe neni 374 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, ashtu që nga i akuzuari Urdhëroi konfiskimin e përhershëm të:a).Substancës narkotike-të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme : 56.49 ± 0.0001 gram, si dhe b).Një (1) pushkë me veprim shul “Crvena Zastava”, model M70, me numër serik: 87875, e kalibrit 8x57JS, një pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik 3 - 9X40EG, pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik 3 - 9X40, pjesë shtesë e pushkës (dylbi) me numër serik ZH204 - ZH224 dhe njëmbëdhjetë (11) paketime me eksplozivë, për të cilat ka urdhëruar Policinë e Kosovës që pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë, të bëjë asgjësimin e kësaj substance si dhe shkatërrimin e armës së zjarrit dhe eksplozivëve, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, Gjykata e mori duke u bazuar në nenet 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Meqenëse palë të dëmtuar dhe kërkesë pasurore–juridike sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit nuk kishte, Gjykata për këtë çështje nuk vendosi fare.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.145/2018, datë 14.03.2025.

Zyrtarja ligjore,

Atdhetare Bashota- Krasniqi

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.